



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Autoriteti i Konkurrencës**  
**Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority**



**Vendimi Nr.25/24**  
**Datë: 13.03.2024**

Duke u bazuar në nenet 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023, Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e 13.03.2024, mori këtë;

## V E N D I M

- I. LEJOHET.** Përqendrimi i ndërmarrjeve lidhur me krijimin dhe funksionalizimin e plotë të një ndërmarrje të përbashkët me përgjegjësi të kufizuar OpCo., nga ndërmarrjet Heinemann Afrika GmbH, Jordanian DutyFree Shops Company dhe Arab Supply & Trading Co.,
- II.** Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55.1.5 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

## Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 19.01.2024, me Nr. Prot. 39/24-11/H, ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit, lidhur me krijimin dhe funksionalizimin e plotë të një ndërmarrje të përbashkët me përgjegjësi të kufizuar OpCo nga ndërmarrjet, Heinemann Afrika GmbH, Jordanian DutyFree Shops Company dhe Arab Supply & Trading Co.,

## Procedurat e ndjekura:

1. Vlerësimi i Lëndës
2. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 13.02.2024
3. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së, me datë 15.02.2023
4. Njoftimi për Përqendrim është i bazuar në Marrëveshjet e palëve, më datë 7 dhjetor 2023, për krijimin dhe marrjen e kontrollit të përbashkët të ndërmarrjes OpCo-së, nga ndërmarrjet Heinemann Afrika GmbH, Jordanian DutyFree Shops Company dhe Arab Supply & Trading Co.

## **Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:**

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

- a. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumën 20,000,000 Euro.
- b. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000 Euro.
- c. Palët kanë për qëllim të ekzekutojnë Marrëveshjen e lidhur me datë 7 dhjetor 2023.

Heinemann Afrika GmbH, është ndërmarrje e inkuorporuar në bazë të ligjeve të Gjermanisë, e regjistruar në regjistrin tregtar të Gjykatës Lokale të Hamburgut, Gjermani, me numrin e regjistrimit HRB 54829, me adrese të regjistruar në KoreaStrasse 3, 20457 Hamburg, Gjermani.

Heinemann Afrika GmbH, është një filial i Gebr. Hainemann SE&KG (GH), është një biznes familjar me seli në Hamburg, që operon dhe furnizon dyqanet, pa taksa udhëtimit në aeroporte, porte detare anije lundruese dhe pika kufitare, në mbarë botën.

GH operon me 350 pika të shitjes me pakicë të produkteve të udhëtimit në 37 aeroporte ndërkombëtarë në bazë të marrëveshjes të konvencionit ose qirasë me operatorët e aeroportit dhe ju shet pasagjerëve produkte të ndryshme më pakicë të cilat, janë të qasshme gjatë udhëtimit, veçanërisht në kategoritë e parfumeve, kozmetikës, alkoolit, duhanit, ushqimeve dhe ëmbëlsirave.

Aktivitetet e GH Group, përfshijnë gjithashtu shitje me pakicë të produkteve të udhëtimit me aeroporte e linja ajrore, operatorët e anijeve turistike dhe tregtare, dyqanet kufitare dhe shitja me pakicë, në zonat e tregtisë lirë.

GH Grupi, ka tre entitete të regjistruara në Kosovë, të cilat kanë qarkullim financiar në vitin 2022 me seli në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës.

- 1. Unifree Kosovo Sh.P.K. me numër unik 810814807**
- 2. Unifree Kosovo Airoport Retailing SH.P.K me numër unik 810711392**
- 3. Unitat Kosovo Retailing LL.C. me numër 810711417**

Jordanian DutyFree Shops Company, ndërmarrje e inkuorporuar në bazë të ligjeve të Jordanisë, me adresë të regjistruar në Kompleksin Ammon, pranë Century Park Hotel, Tunis St. 941601, Amman 11194 Jordani, e regjistruar në Departamentin e Kontrollit të Kompanive Jordaneze, me numër identifikues të ndërmarrjes 200014831, e regjistruar si një shoqëri aksionare publike numër (318), e angazhuar në krijimin, funksionimin dhe investimin në dyqane pa taksa kufitare dhe në çdo zonë të lejuar nga autoritetet zyrtare, po ashtu shet mallra të huaja dhe vendase të importuara në monedha të huaj dhe vendas në dyqane pa taksa. Asnjë nga dyqanet pa taksa të operuar nga JDFS nuk janë të vendosura në aeroportet e Jordanisë. Asnjë entitet nuk ka të regjistruar në Kosovë dhe nuk ka qarkullim për vitin 2022.

Arab Supply & Trading Co., ndërmarrje e inkuorporuar në bazë të ligjeve të Mbretërisë së Arabisë Saudite, me zyrën e saj të regjistruar 6340 AL Ahsa 3108 AL Zahra Dist, Riad 12812, Mbretëria

### **Autoriteti i Konkurrencës**

Adresa: Rr. Migjeni nr. 21, 10000 Prishtinë. Kati i VI, zyra Nr.1  
Tel: +383 /0/ 38 200 109 82 E-mail: [info.konkurrenca@rks-gov.net](mailto:info.konkurrenca@rks-gov.net)



e Arabisë Saudite, me numër CR Nr.1010009592. ASTRA, e cila është e angazhuar në punime të përgjithshme ndërtimi të objekteve rezidenciale dhe jo banesore, rrugëve, përveç termocentraleve.

Nëpërmjet filialeve të tija të kontrolluar nga (ASTRA Group)- është aktiv në bujqësi, prodhim ushqimor, shitje me pakicë dhe shumicë transport ,kujdes shëndetësor, farmaceutik, ndërtim, komunikim, aktiv të pasurit e paluajtshme, investime, konstruksion, çeliku dhe materiale ndërtimi. Duhet theksuar se ASTRA Group nuk ka filiale në Kosovë dhe nuk gjeneronë qarkulluar në vitin 2022.

OpCo, d.o., do të jetë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjeve të Mbretërisë së Arabisë Saudite, selia e regjistruar në Riad Mbretëria e Arabisë Sauditë, emri i ndërmarrjes do të jetë JAH Arabia Internacional ose një emër tjetër për të cilët palët pajtohen unanimitisht, me aktivitetin e saj e cila do të fokusohet në ofrimin e shërbimeve të shitjes me pakicë pa dogane dhe do të operojë dyqanet përkatëse në aeroporte. OpCo, d.o., nuk synon të jetë prezent në tregun e Kosovës.

### **Tregu Përkatës:**

**Tregu Përkatës**, i produktit mund të përkufizohet si shërbime të shitjes më pakicë të produkteve të udhëtimit pa doganë në aeroporte si dhe qendra tjera të transportit, që do të operojë në dyqanet brenda në aeroporte me produkte, parfume, kozmetike, ëmbëlsira, verë, pije alkoolikë dhe duhan.

**Tregu Gjeografik**, ndër të tjera, treg gjeografik përcaktohet dhe Tregu i Republikës së Kosovës, por përcaktimi i tregut gjeografik mund të lihet i hapur.

### **Analiza e Konkurrencës:**

Në bazë të analizave të tregut, Transaksioni i propozuar ka të bëjë më krijimin dhe marrjen e kontrollit të përbashkët të ndërmarrjes OpCo-së, nga ndërmarrjet Heinemann Afrika GmbH, Jordanian DutyFree Shops Company dhe Arab Supply & Trading Co.

OpCo-së, ofron shërbime të shitjes më pakicë të produkteve të udhëtimit pa dogane në aeroporte, që do të thotë, transaksioni i propozuar nuk ngritë ndonjë shqetësim për konkurrencën në tregun përkatës të Republikës së Kosovës, pra nuk do të kufizoj apo do të shtrembëroj konkurrencën në treg, po ashtu nuk mund të forcoj asnjë pozitë dominues, struktura e ndërmarrjeve në treg do të mbetet e njëjtë, pasi që ndërmarrja OpCo, nuk do të ketë shtrirje në tregun e Kosovës, andaj edhe pas transaksionit tregu i Kosovës, mbetet i pa ndryshuar.

### **Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar:**

Transaksioni i propozuar do të realizohet në tregun gjeografik të ZEE ose në Lindjen e Mesme Kërkesa për Njoftimin e Përqendrimit është bërë për arsye GH Group ka tre etnitete të regjistruara në Kosovë të cilat kanë selinë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, Te tri entitet kanë gjeneruar qarkullim financiar në Kosovë në vitin 2022, duhet theksuar se ndërmarrja HA nuk ka gjeneruar qarkullim financiar në vitin 2022.

Komisioni vlerëson se përqendrimi, nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se

Autoriteti i Konkurrencës

Adresa: Rr. Migjeni nr. 21,10000 Prishtinë. Kati i VI, zyra Nr.1  
Tel: +383 /0/ 38 200 109 82 E-mail: [info.konkurrenca@rks-gov.net](mailto:info.konkurrenca@rks-gov.net)

**Shënim:**

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti-konkurrese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij, Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

Neime Binaku-Isufi  
Kryetare



Kaltrina Sela  
Zv. Kryetare

Nafije Osdautaj  
Anëtare

Florent Mehmeti  
Anëtar

Salihe Gashi-Loku  
Anëtare

III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva